

Aneksi 7

FTESË PËR OFERTË

Emri: Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve (SDC)
Adresa: Rr.Gjin Bue Shpata; Pall.Aviacioni Vjeter; 6/29 ;Tirana-Albania
E-mail: info@sdc.org.al
Afati i dorëzimit të ofertës: Brenda dates 15 Tetor 2022

Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve (SDC) po zbaton projektin "Local Natural Cultural Values for Sustainable Tourism in the Municipality of Kavaja". Vlerat natyrore kulturore lokale për turizëm të qëndrueshëm në Bashkinë Kavajë në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të organizojë disa aktivitete për të cilat është i nevojshëm ambjenti për zhvillimin e tyre si dhe vendosjen e 2 Info Points - tabela, të cilat do të rrisin shikueshmërinë e turistëve vendas dhe të huaj, atë të vlerave kulturore dhe historike duke promovuar dhe inkurajuar vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë për të vizituar qytetin e Kavajës dhe rrethinat e saj "Jo vetëm turizmi gjatë verës, por gjatë gjithë vitit".

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më date 15 Tetor 2022 , në adresën e e-mailit: info@sdc.org.al ose në adresën postare Rr.Gjin Bue Shpata;Pall.Aviacioni Vjeter;6/29; Tirane-Shqiperi

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, "Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve" (SDC) do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/ shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH
	2 tabela Info Point	Leke
1	Përmasat e strukture mbajtëse 230 x 150 cm	
2	Materiali tabelës me informacion 150 x 120 cm	
3	Profilet anësore 60 x 60 2 mm spensor	

4	Zgara profil 30 x 30	
5	Informacioni material alukobond me adheziv të branduar	
7	Dy anë	
8	Montim 2 tabelat.(1 Tabele në qendër të qytetit Kavaje dhe 1 tabelë tek rrethrrutullimi Mali Robit	

Specifikime te pergjithshme teknike:

Ofrimi i ketij shërbimi kërkohet për periudhën 15 Tetor deri 10 Nentor 2022. Datat specifike do të përcaktohen në kontratën e lidhur me subjektin fitues

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;
 - 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Kavaje
 - 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës info@sdc.org.al; brenda datës 15 Tetor 2022 ose në adresën postare : Rr.Gjin Bue Shpata;Pall.Aviacioni Vjeter;6/29; Tirane-Shqiperi
- Nuk pranohen ofertat dorazi.**
- 4) Pagesa e subjektit kryhet me transfertë bankare pas marrjes së shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB te marre deri nje dite para postimit te ofertes;
- 2) Ofertën financiare për produktin sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.
